

Isuf ÇELAJ



Datëlindja: 13.11.1964

Vendlindja: Tropojë

E-mail: Isuf.Çelaj@parlament.al

Jetëshkrimi

Ka përfunduar studimet në Universitetin Bujqësor, Fakulteti i Mjekësisë Veterinare, Kamzë, Tiranë (1984-1988). Është diplomuar gjithashtu në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, dega juridik (1996-2003). Në periudhën (2006-2007) ka marrë një diplomë për studimet mbi policinë.

Ka mbajtur pozicione të rëndësishme në ministrinë e Brendshme, si: Sekretar i Përgjithshëm (2012-2013); Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse (2005-2012); këshilltar i ministrit të Brendshëm për Çështjet e Policisë në periudhën (shtator 2005-nëntor 2005); shef i pasaportave në Drejtorinë e Rendit dhe Sigurisë Publike (1995-1998).

Nga nëntori i vitit 2013 deri në vitin 2017 ka qenë Drejtor i Departamentit të Menaxhimit në subjektin privat “GENER 2” sh.p.k. Ka qenë, gjithashtu, menaxher i firmës së ndërtimit “GENER 2” Tiranë (1998-2005); pedagog në Universitetin Bujqësor të Tiranës (1988-1992).

Nga korriku i vitit 2013 e në vazhdim është anëtar i Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike; koordinator i Partisë Demokratike pranë degës nr.1 Tiranë dhe nga janari i vitit 1991 anëtar i Partisë Demokratike.

Ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë në periudhën 2017-2019 dhe aktualisht është deputet i qarkut të Kukësit në Legjislaturën X.

Ka kryer një sërë trajnimesh dhe kualifikimesh, si:

Kurs trajnimi për ruajtjen e objekteve dhe sigurisë fizike të personave, SHBA nëntor 2006 - korrik 2007; kurs trajnimi për drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit me temë “Drejtimi

dhe menaxhimi i strukturave të policisë”, organizuar nga PAMECA;
2006 kurs trajnimi disaditor, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, “Menaxhim i kufijve”,
organizuar nga DCAF (Kontrolli Demokratik i Forcave të Armatosura);
2006 kurs trajnimi disaditor në Austri, “Problemet e menaxhimit të shërbimeve mbështetëse;
17 qershor – 17 korrik 2008 Menaxhimi Ekzekutiv.